



Datë: 06.02.2026

Numër Protokolli: 675/2026

A.nr.2065/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.2065/2025, të datës 23.12.2025, të parashtruar nga ankuesja F.H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Përgjigja me numër reference: 14-117/01-186380/25 e datës 16.12.2025 e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* te organi i njëjtë.

II. Obligohet Udhëheqës i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, që të rishqyrtojë dhe rivendos për kërkesën e ankueses të datës 12.12.2025, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 23.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar nën shenjë A.nr.2065/2025 dhe numër protokolli:8016/2025, kundër Përgjigjes me numër reference: 14-117/01-186380/25 e datës 16.12.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

26.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 02.02.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 30.01.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:538/2026, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjë A.nr.2065/2025 të datës 23.12.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 8016/2025 të datës 23.12.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Kryetarit të Këshillit, i datës 30.01.2026; Vendimin e datës 25.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 30.01.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Kërkesën e ankueses të datës 12.12.2025; Përgjigjen e datës 16.12.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Kopjen e ID-së së ankueses; Shkresën e datës 23.10.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 26.12.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 30.01.2026; Akt Emërimit të datës 01.10.2022.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ekzistojnë rrethana ligjore që lënda të kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje*, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.10.2022 është e punësuar në Komunën e Prishtinës, në pozitën “Zyrtare e lartë për shëndetësi”, në kuadër të Drejtorisë së shëndetësisë.

Ankuesja me datë 12.12.2025 pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore ka parashtruar kërkesë për kompensim material në mënyrë retroaktive për përvojë të punës dhe atë pwr periudhën kohore nga data 01.09.2019 e deri me datë 30.04.2024, ashtu që kërkesën në fjalë e mbështet në Vendimin e datës 30.01.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, ku sipas të cilit vendim ankueses në fjalë i ishte konfirmuar përvoja e punës në kohëzgjatje prej njëzetën (21) e tre (3) muaj.

Në kërkesën e ankueses, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me datë 16.12.2025 i kishte kthyer Përgjigje me shifër reference: 14-117/01-186380/25, sipas së cilës e njofton të njëjtin se lidhur me kërkesën e saj për kompensim material, është vepruar sipas vendimit të Këshillit, ashtu që pagesa për kërkesën në fjalë është kompensuar për periudhën kohore nga data 01.05.2024 e deri me datë 31.05.2025, çështje për të cilën organi i punësimit ka nxjerrë Vendimin e datës 25.06.2025.

Ankuesja në ankesën e parashtruar kundër përgjigjes së datës 16.12.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, pretendon se organi i punësimit nuk ka shqyrtuar kërkesën e saj, ngase e njëjta sipas Vendimit të Këshillit të datës 19.06.2025 e ka fituar të drejtën në kompensim për periudhën kohore nga data 01.05.2024 e deri me datë 31.01.2025, fakt ky i cili mbështetet edhe përmes Vendimit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 25.06.2025, ashtu që ankuesja thekson faktin se në kërkesën e saj të datës 12.12.2025 ka kërkuar të kompensohet për periudhën tjetër kohore dhe atë nga data 01.09.2019 e deri me datë 30.04.2024 sipas pritshmërive të ligjshme sikurse është vendosur edhe paraprakisht.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se ankuesja fillimisht me datë 15.04.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshilli kundër heshtjes administrative të organit të punësimit, në kërkesën e saj të datës 14.03.2025 sipas të cilës kishte kërkuar kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive për periudhën

kohore nga data 01.05.2024 e deri me datë 31.05.2025, ashtu që pasi që ishte konstatuar fakti se organi i punësimit kishte heshtur në kërkesën e saj të datës 14.03.2025, Këshilli përmes Vendimit A.nr.652/2025 të datës 19.06.2025 e kishte aprovuar ankesën e ankueses, ndërsa e kishte detyruar organin e punësimit, gjegjësisht Njësinë për menaxhimin e Burimeve Njerëzore që të shqyrtojë kërkesën e ankueses të datës 14.03.2025. Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me datë 25.06.2025 ka nxjerrë Vendimin Nr:14-030/01-0091278/25 përmes të cilit ankueses ia ka njohur të drejtën në kompensim material në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga data 01.05.2024 e deri me datë 31.01.2025.

Thënë si më lartë, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe konstatimit të gjendjes faktike mbi bazën e provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me rastin e nxjerrjes së përgjigjes së datës 16.12.2025, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara nga nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative”*, ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, ku përcaktohet se: *“1. Krahës kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë”*, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se Përgjigja me numër reference: 14-117/01-186380/25 e datës 16.12.2025 është akt i paligjshëm sikurse parashihet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkëlqes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”* pasi që në rrethanat e rastit konkret njësia përkatëse nuk ka shqyrtuar pretendimin e palës si në kërkesën e saj të datës 12.12.2025, ngase pala kishte kërkuar kompensimin në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga data 01.09.2019 deri 30.04.2025, periudhë kohore për të cilin nuk ishte vendosur as përmes Vendimit të Këshillit A.nr.652/2025 të datës 19.06.2025 dhe as përmes Vendimit të datës 25.06.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, sikurse përveç tjerash akti i konstatuar nuk përmban elementet e aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, dhe po ashtu arsyetimi i aktit në fjalë është i mangët apo i barabartë me mungesën e tij.

Prandaj, nga se u pasqyrua sikurse në arsyetimin e këtij vendimi dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u mbështetur në dispozitat e aplikuara të LPPA-së, neni 55 paragrafi 1, vendosi që të shfuqizoi Përgjigjen me numër reference: 14-117/01-186380/25 e datës 16.12.2025 e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, Njësia e Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, ashtu që kjo e fundit me rastin e rishqyrtimit të lëndës, respektivisht të kërkesës së ankueses të datës 12.12.2025, duhet të zbatojë drejtë dispozitat ligjore në fuqi qw rregullojnë kwtw qwshtje, e veçmas nenin 4 paragrafi 1 dhe nenin 8 të LPPA-së, si dhe të marrë përbazë pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paraagrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2065/2025, datë 06/02/2026

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.H;
- Komunës së Prishtinës (*Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore*), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.